



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Prot. 249

Tiranë, më 28. 06. 2018

Vendim nr. 8, datë 28. 06. 2018

Për shpalljen e konkursit të çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, edicioni i tretë (2018)

(Themeluar me Vendimin nr. 5, datë 10 tetor 2016)

Drejtuar: Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike në Akademinë e Shkencave;
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike në Akademinë e Shkencave;
Sektorit të bibliotekës dhe të botimeve shkencore; Sektorit të financës;
Sektorit të personelit.

Për dijeni: Asamblesë së Akademisë së Shkencave;

Mbështetur në Rregulloren *Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*, shpallet hapja e rendit të tretë (2018) të **konkursit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë u drejtohet bashkësive shkencore dhe studiuesve brenda e jashtë vendit me thirrjen për të marrë pjesë në konkursin shkencor kombëtar vjetor 2018 për këto çmime shkencore kombëtare:

- Çmimi *Çabej*, çmim shkencor kombëtar në fushën e shkencave shoqërore e albanologjike;
- Çmimi *Radovicka*, çmim shkencor kombëtar në fushën e shkencave natyrore e teknike;
- Çmimi i *karrierës akademike për merita dhe vepra jetësore*;
- Dy çmime për *kërkuesin e ri më të suksesshëm*, gjegjësisht për shkencat shoqërore-albanologjike dhe natyrore-teknike.

2. Shpallja e interesit për pjesëmarrje fillon nga data 1 korrik 2018 dhe përfundon më datën 31 dhjetor 2018.

3. Në çmimet kombëtare shkencore pranohen vepra me karakter original (botime monografike, projekte kërkimore dhe patenta shkencore të regjistruara), që janë botuar, publikuar a regjistruar gjatë vitit 2018.

4. Pjesëmarrës në konkursin për çmimet shkencore kombëtare 2018 mund të jenë: studiues nga Republika e Shqipërisë, nga gjithë hapësira historike shqiptare dhe nga diaspora; albanologë e shkencëtarë të huaj me veprimtari të shquar aktive në shkencën shqiptare.

5. Kandidatët mund të propozohen nga institucionet kërkimore-shkencore ku kryejnë veprimtarinë e tyre, nga botues dhe subjekte të tjera jopublike. Kandidatët mund dhe të vetëpropozohen.

Për vepra me karakter institucional, propozues e pjesëmarrës mund të jenë njësitë themelore të kërkimit shkencor akademik e universitar (departamente, qendra e institute kërkimore shkencore), të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në sistemin kombëtar të kërkimit shkencor në vend.

Kandidimet pranohen për vepra me një autor dhe me shumë autorë, për vepra vetjake e institucionale.

6. Kandidati i vetëpropozuar ose i propozuar nga një qendër kërkimore, ent botues apo subjekt tjetër; dhe/ose subjekti i kandiduar për një vepër shumautorëshe, duhet të paraqesë zyrtarisht pranë zyrës së protokollit të Akademisë së Shkencave këto dokumente:

- *Një kërkesë vetjake të motivuar*;
- *Curriculum vitae*;
- *Listën e bashkautorëve dhe/ose përbërjen e redaksisë (për veprat me shumë autorë dhe nismat shkencore institucionale)*;
- *Dy kopje të studimit / projektit të botuar. Në përfundim të konkursit botimet hyjnë në fondin e bibliotekës shkencore të Akademisë së Shkencave*;
- *Certifikatën e regjstrimit të patentës*;
- *Deklaratën e autorësisë së punës kërkimore shkencore/patentës*;
- *Një përmbledhje analitike në gjuhën angleze për studimin e paraqitur*;

- Deklaratën për pranimin e kushteve të konkurrimit;
- Dy rekomandime për veprën e kandidatit konkurrues prej institucionesh të specializuara kërkimore akademike-universitare janë të mirëpritura;
- Kur çmimi i jepet një institucioni, ai depoziton gjithashtu: aktin e themelimit, statutin, kopje të dokumentit si person ligjor, deklaratën e pranimin të konkurrimit për çmimin sipas Rregullores së çmimeve.

7. Juria shpall listën e plotë të konkurrentëve të propozuar dhe/ose të vetëpropozuar jo më vonë se dyjavëshi i parë i muajit janar të vitit 2019.

8. Juria përzgjedh nga numri i përgjithshëm i kandidatëve jo më shumë se 4 (katër) prej tyre për t'i shpallur të nominuar për secilin çmim. Nominimi njoftohet nga juria jo më vonë se dyjavëshi i parë i muajit shkurt 2019;

9. Pas nominimeve, deri në shpalljen e fituesve, juria krijon mundësitë që të nominuarit të paraqiten me ligjërata shkencore-akademike për çështje të trajtuara në veprat e paraqitura në konkurs prej tyre në forume shkencore publike me audiencë të specializuar.

10. Fituesve të çmimeve shkencore kombëtare u jepen:

- Diploma si fitues, me nënshkrimin e kryetarit të jurisë dhe të Kryetarit të Akademisë; diploma përmban emrin e fituesit, titullin e çmimit, motivacionin, nënshkrimet e autoritetit vendimmarrës dhe numrin e amzës;
- Stemën e institucionit që jep çmimin, të personalizuar;
- Për fituesit e çmimit Çabej, Radovicka dhe të karrierës, juria jep gjithashtu shenjën artistike të tyre;
- Fituesit e çmimeve shkencore kombëtare kanë të drejtën e një shpërblimi financiar, që vendoset nga Kryesia e Akademisë.

11. Për komunikimet teknike-zyrtare pranë Akademisë së Shkencave ngrihet sekretaria e jurisë.


12. Shpallja e laureatëve fitues të çmimeve vjetore kombëtare bëhet me një ceremoni të posaçme publike brenda muajit mars të vitit 2019.

13. Ngarkohen seksionet shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

14. Ngarkohet specialisti IT dhe specialisti i komunikimeve shkencore për publikimin dhe njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 28.06.2018



Shih: <http://akad.gov.al/ash/2016-10-06-11-54-37/rregullore>